



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 16 dhjetor 2013  
Nr. ref.:RK525/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI42/13**

Parashtrues

**Shahire Beqiraj**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2010, të 7 shkurtit 2013**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruese është znj. Shahire Beqiraj, nga fshati Vrellë, komuna e Istogut.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2010, të 7 shkurtit 2013, të cilin parashtruesja nuk e ka potencuar se kur e ka pranuar.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 170/2010, të 7 shkurtit 2013, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses, është shkelur neni 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) dhe neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e pronës në mes të parashtrueses së kërkesës dhe A. B në lidhje me përcaktimin e së drejtës në pronën e regjistruar në parcelat kadastrale nr. 510/2, 870/1 dhe 892/2, nga fletëposedimi nr. 213 ZK në fshatin Vrellë.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe në nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 nëntorit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesja, më 20 mars 2013, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 25 mars 2013, Kryetari, me Vendimin nr. 42/13, e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. 42/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 4 prill 2013, Gjykata informoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 qershor 2013, parashtruesja dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë, "Procesverbal mbi marrjen e së dëmtuarës në pyetje".
9. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

10. Më 26 shkurt 1982, Gjykata Komunale në Istog, duke vendosur sipas propozimit të R. B., për ndarjen fizike të pasurisë së tij, nxori Vendimin nr. 28/82 dhe vendosi për shpëputjen e bashkësisë familjare në mes të R. B., C. B. dhe Sh. B.

11. Më 28 qershor 1988, Gjykata Komunale në Istog nxori Aktvendimin N. Nr. 125/88, me ç'rast e aprovon propozimin për ndarjen fizike të pasurisë së R.B., me ç'rast parashtrueses së kërkesës i takon ¼ e shtëpisë dhe e tërë ngastra, të cilat evidentohen sipas fletëposedimit nr. 213 ZK Vrellë, si dhe ½ nga 1/10 e tokës nga të gjitha ngastrat, të cilat evidentohen sipas fletëposedimit të përbashkët, nr. 269 ZK-Vrellë.

12. Më 12 shtator 2008, Gjykata Komunale në Istog, duke vendosur në kontestin juridiko-civil të A. B. për vërtetimin e pronësisë, nxori Aktgjykimin në bazë të trashëgimisë, C. Nr. 41/02, duke vërtetuar se:

*“A. B., në bazë të ndarjes fizike të bashkësisë familjare dhe të pasurisë, është pronar i paluajtshmërisë së përbërë nga ngastrat kadastrale nr. 510/2..., nr. 870/1... dhe nr. 892/4... sipas fletëposedimit nr. 213 ZK Vrellë”.*

Më tej në arsyetimin e vet, Gjykata Komunale në Istog thekson: *“kjo gjykatë vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe si e tillë është miratuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.*

13. Më 22 prill 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruar nga parashtruesja e kërkesës dhe R. Q. kundër Aktgjykimit C. Nr. 41/02, të 12 shtatorit 2008, nxori Aktgjykimin Ac. Nr. 490/08 dhe e refuzon si të pabazuar ankesën e parashtrueses. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Qarkut në Pejë më tutje thekson:

*“... Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354 paragrafi 2 të LPK-së, të cilat Gjykata, sipas shkallës së dytë, i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 365 paragrafi 2 të LPK-së”.*

14. Më 14 qershor 2010, parashtruesja e kërkesës dhe R.Q., përmes të autorizuarit të tyre, i janë drejtuar Prokurorit të Republikë së Kosovës të ngrejë “kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë” pasi që konstaton “... shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të gjykatës së shkallës së dytë nga neni 194 i LPK-së, sepse nga gjykata e shkallës së parë ka toleruar shkeljen thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182 al 2 pika 1 të LPK-së...”.

15. Në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë dokument që tregon se a ka vendosur Prokurori i Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

16. Më 7 shkurt 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur përkitazi me revizionin e parashtrueses së kërkesës dhe motrës së saj, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 170/2010, e refuzon si të pabazuar revizionin. Gjykata Supreme më tej në arsyetimin e saj thekson:

*“... gjykata e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i kanë zbatuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të*

*drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia është e bazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i goditur përmbajnë arsye të mjaftueshme për fakte relevante, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë...”*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

17. Parashtruesja konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 170/2010, të 7 shkurtit 2013, duke pretenduar shkeljen e nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) dhe nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës si dhe kërkon nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

*“Dëshiroj që të më mundësohet dhe të dëshmohet se në procedurë para gjykatave të rregullta nuk është zhvilluar një procedurë e bazuar në ligj dhe Kushtetutë, e që ka pasur epilog në dëm timin dhe përfitime pronësore të padrejta të kundërshtarit tim”.*

*“Përkatësisht të përfundohet se ndaj meje nuk është zhvilluar një procedurë gjyqësore që do të siguronte barazinë e palëve në procedurë”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

18. Fillimisht, për të gjykuar kërkesën e parashtrues, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesja i ka plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë, e qartësohen më tutje me Ligj dhe Rregullore të punës.
19. Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili përcakton që:

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata vëren që parashtruesja është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

20. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesja, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe nenit 47 (2) të Ligjit, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, parashtruesja ka paraqitur fakte që i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi.
21. Parashtruesja gjithashtu duhet të vërtetojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të caktuar. Mund të shihet nga shkresat e lëndës që kërkesa është dorëzuar brenda afatit katër (4) mujor, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

22. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36.2 të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;”

23. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-I, shih edhe Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. 70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).
24. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesja të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
25. Në bazë të shkresave të rastit, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë me aktvendimin e nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Pejë është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në Gjykatën Supreme nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009). Për më tepër, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 170/2010, i 7 shkurtit 2013, është i qartë dhe i arsyetuar mirë.
26. Për më tepër, parashtruesja nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (Shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesja nuk argumenton se në çfarë mënyre janë shkelur neni 22 dhe neni 31 i Kushtetutës.
27. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e dorëzuara nga parashtruesja nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesja nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e saj, prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2013, njëzëri:

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani